

Flamurtari/ Bashkia gjen 10 milione leke shperblim per fitoren me Partizanin

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 19 Dhjetor 2013 23:34



Bashkia e Vlores po i qendron prane skuadres dhe Flamurtari po merr rezultate te mira per tu larguar shume shpejt nga zona e rrezikut. Se fundmi, per ta mbyllur vitin me tre pike dhe nje sukses ne Vlore, drejtuesit kane gjetur 10 milione leke per skuadren. Shperblimi I eshte vendosur Flamurtarit per te mundur Partizanin, skuader qe nuk ka luajtur prej disa vitesh ne Vlore. Interesimi per kete ndeshje pritet te jete i madh pasi te kuqte vijne me vendin e dyte ne xhеп ndersa Flamurtari eshte rikthyer tek rezultatet e mira e tani shikon per lart ne tabelen e klasifikimit. 10 milione leke shperblim jane nje shume e madhe qe pritet te motivoje me teper futbollistet vlonjat.